KËRKESË
Nr. 105/2, datë 25.1.2022

PËR SHPRONËSIM PUBLIK

Agjencia Shtetërore për Shpronësimin shpall kërkesën për shpronësim për interes publik të pronarëve të pasurive, pronë private, që preken nga realizimi i objektit "Rivitalizimi i rrugës 'Andon Profka' dhe i hapësirave përreth saj, Fier".

Subjekti kërkues i këtij projekti është Bashkia Fier.

Me anë të këtij publikimi kërkojmë të vëmë në dijeni personat e prekur nga ky shpronësim, për interes publik, për pasuritë e paluajtshme, pronë private, të cilat do të kompensohen sipas vlerësimit paraprak të llogaritur si më poshtë vijon:

1. Për pasuritë e llojit "truall", vlerësimi është kryer bazuar në vendimin nr. 89, datë 3.2.2016, të Këshillit të Ministrave "Për miratimin e hartës së vlerës së tokës në Republikën e Shqipërisë".

2. Për pasuritë e llojit "ndërtesë/njësi", vlerësimi është kryer sipas VKM-së nr. 138, datë 23.3.2000, "Për kriteret teknike të vlerësimit dhe të përllogaritjes së masës së shpërblimit të pasurive që shpronësohen, të pasurive që zhvlerësohen dhe të të drejtave të personave të tretë, për interes publik", të ndryshuar.

Personat që preken nga ky projekt, të cilët kanë emrin në tabelën e publikuar dhe personat, të cilët preken, por nuk figurojnë në këto lista, jo më vonë se 15 (pesëmbëdhjetë) ditë nga publikimi në Fletoren Zyrtare, kanë të drejtë të paraqesin pretendimet e tyre, të shoqëruara me dokumentacionin përkatës, si edhe të shprehen nëse janë dakord me të dhënat e publikuara për përfundimin e procedurave të shpronësimit në Bashkinë Fier, si dhe në Agjencinë Shtetërore për Shpronësimin.

Vlera totale paraprake e shpronësimit është 6,084,267 (gjashtë milionë e tetëdhjetë e katër mijë e dyqind e gjashtëdhjetë e shtatë) lekë.

DREJTOR I PËRGJITHSHËM
KRYETAR I KOMISIONIT
TË POSAÇËM TË SHPRONËSIMEVE
Erlis Hereni

LISTA EMËRORE PARAPRAKE E PRONAVE DHE E PRONARËVE, QË DO TË SHPRONËSOHEN PËR OBJEKTET (PËR OBJEKTET E BANIMIT, SHËRBIMIT DHE TRUALLIT), QË PREKEN NGA REALIZIMI I PROJEKTIT "RIKONSTRUKSIONI I RRUGËS 'ANDON PROFKA"'

Nr.	Emër Atësia Mbiemër	Zona kad.	Nr. i pas.	Sip. e truallit (m^2)	Sip. e objektit të shërbimit (m^2)	Lloji i pasurisë	Çmimi i truallit (l/m^2)	Vlera e objektit të shërbimit, sipas situacionit (lek)	Vlera e truallit (lek)	Vlera totale e truallit dhe objektit shërbimit (lek)	KONFIRM. ZVRPP
1	2	3	4	5	6	7	8	9	10	11	12
1	Gezim Malo Muhaj	8534	4/59	13.2		truall	12,893		170,187.60	**170,187.60**	Me certifikatë pronësie
2	Darvin Xhemal Lloshi	8534	4/115	7.6		truall	12,893		97,986.80	**97,986.80**	Me certifikatë pronësie
3	Enver Xhemal Lloshi	8534	4/21	14.6		truall	12,893		188,237.80	**188,237.80**	Me certifikatë pronësie
4	Sulejman Barjam Dine	8534	5/201-ND	47	47	truall +njësi	12,893	1,519,465	605,971.00	**2,125,436.00**	Me certifikatë pronësie
5	Rexhep Sula	8534	5/163-N2		42	njësi		1,210,398	-	**1,210,398.00**	Me certifikatë pronësie
6	Latif Behar Sakaj	8534	5/163-B1		34.4	bodrum		991,372	-	**991,372.00**	Me certifikatë pronësie
7	Festim Hamitaj	8534	5/163-N1		42	njësi		1,210,398	-	**1,210,398.00**	Me certifikatë pronësie
8	Novruz Teki Zylalaj Donald Teki Zylalaj Qemal Teki Zylalaj	8534	4/24+1-1 4/24+1-2 4/24+1-3	7		truall	12,893		90,251.00	**90,251.00**	Me certifikatë pronësie
Vlera totale paraprake										**6,084,267.2**	

Shënime:

1. Për tokën "truall", çmimi i llogaritur është marrë nga vendimi nr. 89, datë 3.2.2016, i Këshillit të Ministrave, "Për miratimin e hartës së vlerës së tokës në Republikën e Shqipërisë".

2. Për pasuritë e llojit "ndërtesë me funksion njësi" është bërë sipas VKM-së nr. 138, datë 23.3.2000, "Për kriteret teknike të vlerësimit dhe të përllogaritjes së masës së shpërblimit të pasurive që shpronësohen, të pasurive që zhvlerësohen dhe të të drejtave të personave të tretë, për interes publik", të ndryshuar.